



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Analizë e Kuadrit Ligjor mbi Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri



© 2019 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Autorët: *Juliana Hoxha*
Erila Haska

Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit “**EMBRACE**” - **Modele Sipërmarrjeje që Ndërtojnë Marrdhënie dhe Ekonomi Krijuese** me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Abstrakt

Sipërmarrjet sociale konsiderohen si sipërmarrje me qëllim social, një model hibrid ku biznesi dhe organizatat jofitimprurëse ndërlidhen në një entitet. Sipërmarrja sociale dhe ndërmarrjet sociale si një fushë në zhvillim janë relativisht të reja dhe të diskutueshme si përkufizime. Në dekadën e fundit ka një përpjekje në rritje të aktorëve për të rregulluar këtë fushë duke përfshirë edhe nivelet politikëbërëse, të cilët kanë kuptuar potencialin e madh të sipërmarrjes sociale. Gjithmonë e më shumë sipërmarrja sociale po konsiderohet si një mjet i rëndësishëm drejt një shoqërie të drejtë, një kontributor në zhvillimin social dhe ekonomik.

Në shumë vende të BE-së ka një trend në rritje të zhvillimit të sipërmarrjeve sociale që kontribuojnë në përfshirjen sociale, punësimin dhe të ardhurat e vendit. Sipërmarrjet sociale po rritet në fusha ku sektori privat nuk operon si trajnimi profesional, integrimi në forcën e punës, kujdesi social dhe strehimi, por jo vetëm. Për këtë arsye, shumë qeveri dhe institucione ekonomike – politike si OECD dhe Komisioni Evropian po fokusojnë vëmendjen e tyre drejt stimulimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes sociale.

Në Shqipëri, sipërmarrjet sociale dhe institucionet shtetërore kanë debatuar për thuajse një dekadë nevojën për të rregulluar ose jo këtë sektor, dhe mënyrën si duhet ta bëjnë, duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë e formave ligjore, diversitetin në qëllimin e veprimtarisë së tyre dhe mjedisin mundësues që nevojitet për aktivitetin e tyre. Në 2016, Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”¹ hyri në fuqi, i ndjekur nga një numër aktesh nënligjore të nxjerra gjatë një periudhe tre vjeçare. Paketa ligjore e cila nuk është zbatuar ende për shkak të paqartësive që mbart është duke shenjuar një mundësi të humbur për ndërmarrjet sociale në Shqipëri.

Kjo analizë ofron një përmbledhje sintetike të paketës ligjore dhe paraqet disa çështje kyçe në legjislacion që përfaqësojnë barriera për aktivitetin e sipërmarrjeve sociale. Si pjesë e analizës janë referuar praktika ligjore nga vendet e Evropës.

Ne besojmë që analiza do të kontribuojë në një kuptim më të mirë të nevojave zhvillimore të sektorit të sipërmarrjeve sociale nga institucionet shtetërore në vend. Në vijim, kjo do të ndihmojë sektorin e sipërmarrjes sociale në zhvillimin e përpjekjeve të tyre advokuese bazuar në evidenca dhe analiza faktesh.

¹ Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjes Sociale në Republikën e Shqipërisë”, datë 9 qershor 2016. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf

Tabela e Përmbajtjes

Abstrakt	3
Çfarë është Sipërmarrja Sociale	5
Përmbledhje e Paketës Ligjore mbi Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri	7
Analiza e kuadrit ligjor	8
Përqasja e Ligjit	8
Modeli i ndërmarrjes sociale sipas ligjit	10
Forma e Organizimit	11
Kriteret Ekonomike dhe Sociale në ligj	12
Financimi i ndërmarrjeve sociale	13
Përfundime	18
Referenca	20
Partnerët Shqipëri dhe Sipërmarrja Sociale	21

Çfarë është Sipërmarrja Sociale

Sipërmarrjet sociale shihen si entitete hibride që bëjnë bashkë qëllimin jofitimprurës mbi vlerat sociale, praktikat e biznesit në manaxhim dhe shfrytëzimin e burimeve ekonomike (Austin, Stevenson, & Wei-Skillern, 2006). Ky dualitet konsiderohet si “vija e dyfishtë”. Sipërmarrjet sociale shfaqen në dy lloje formash organizative, jofitimprurëse dhe fitimprurëse.

Ka dy shkolla kryesore mendimi mbi konceptin e sipërmarrjes sociale të lindura në Amerikë. Shkolla e parë është e lidhur me strategjinë e “të ardhurave të fituara”, një strategji që ndërmerret nga organizatat për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të misionit të saj social. Kjo qasje më vonë u zgjerua duke përfshirë të gjitha organizatat që tregtojnë për një qëllim social, duke përfshirë dhe kompanitë fitimprurëse. Nocioni i biznesit social përfshihet në këtë shkollë mendimi. Sipas Yunus (2010), një biznes social është një kompani pa dividend, pa humbje e dizenuar për të adresuar një objektiv social. Ndërsa shkolla e dytë është ajo e “Inovacionit Social”, e cila i jep një rol qendror dinamikës së inovacionit social që në pjesën më të madhe të kohës udhëhiqet nga sipërmarrësi social, i cili zotëron karakteristikat për të ndjekur misionin social, si dinamizmi, krijueshmëria dhe udhëheqja (Petrella & Richez-Battesti, 2014).

Ndërsa në Evropë, shkolla kryesore e mendimit lidhet ngushtësisht me rrjetin EMES në vitet 1990, ku përkufizimi i sipërmarrjeve sociale karakterizohet nga 9 kritere, të ndara në tre grupe:

a) kriteri i parë lidhet me *dimensionin ekonomik* të aktivitetit (një aktivitet i vazhdueshëm që prodhon të mira dhe/ose shërbime, një nivel i konsiderueshëm risku ekonomik, prezenca e të paktën një minimumi punonjësish të paguar);

b) kriteri i dytë lidhet me *dimensionin social* dhe përfshirës (një qëllim eksplicit i përfitimit të komunitetit, një iniciativë e lançuar nga një grup qytetarësh, një shpërndarje e kufizuar e fitimit);

c) dimensionin e *strukturës së qeverisjes* (një shkallë e lartë autonomie, një fuqi vendimarrëse jo e bazuar te pronësia e kapitalit, një natyrë me pjesëmarrje, e cila përfshin palë të ndryshme që ndikohen nga aktiviteti) (Defourny & Nyssens, 2012).

Forma ligjore e sipërmarrjes sociale mund të variojë dhe nuk është e rëndësishme në aktivitetin e saj. Sipërmarrjet sociale të organizuara si fitimprurëse performojnë të njëjtin lloj aktiviteti si ato jofitimprurëse (Townsend & Hart, 2008). Forma ligjore është thjesht një vendim i sipërmarrësit social, i cili bazohet në lehtësinë që forma institucionale ofron në përmbushjen e qëllimit social. Sipërmarrjet sociale operojnë në formën e kooperativave sociale, kompanive private, shoqatave të bashkëpunimit reciprok, organizatave jofitimprurëse, ose fondacioneve.²

² Url: https://ec.europa.eu/growth/sectors/social-economy/enterprises_nl

Në 2011, Komisioni Evropian lançoi Iniciativën e Biznesit Social, duke identifikuar aktivitete që bëjnë diferencën reale dhe përmirësojnë situatën në terren për sipërmarrjet sociale.

Sipas KE sipërmarrjet sociale janë:

- *“ato për të cilat objektivi social dhe shoqëror i të mirës së përbashkët është arsyeja për aktivitet tregtar, shpesh në formën e një niveli të lartë inovacioni social”*,
- *“ato ku fitimet riinvestohen kryesisht me qasjen e arritjes së objektivit social”*,
- *“dhe, ku metoda e organizimit ose struktura e pronësisë reflekton misionin, duke përdorur principe me pjesëmarrje ose demokratike, ose fokusohet në drejtësinë sociale”*.²

Brenda kuadrit të principeve, Komisioni Evropian e konsideron sipërmarrjen sociale si “biznese që ofrojnë shërbime sociale dhe/ose të mira dhe shërbime ndaj grupeve vunerabël... dhe/ose...biznese që prodhojnë të mira dhe/ose shërbime me një objektiv të veçantë, por aktiviteti i të cilave mund të jetë jashtë sferës së të mirave ose shërbimeve sociale”.³

KE pasqyron se pavarësisht diversitetit, sipërmarrjet sociale kryesisht operojnë në 4 fushat e mëposhtme:²

- “Integrimi në Punë – trajnimi dhe integrimi i personave të papunë dhe nga grupe të marginalizuara;
- Shërbime sociale personale – kujdesi shëndetësor, trajnime profesionale, arsim, shërbime mjekësore, shërbimet e kujdesit të fëmijëve, shërbimet për personat e moshuar, ose ndihmë për persona të disavantazhuar;
- Zhvillimi lokal i zonave të disavantazuara – sipërmarrjet sociale në zonat rurale, skemat e rehabilitimit/zhvillimit të lagjeve në zonat urbane, ndihma zhvillimore dhe bashkëpunim me vendet e treta;
- Tjetër – përfshin riciklimin, mbrojtjen mjedisore, sportet, artet, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike, shkenca, kërkimi shkencor dhe inovacioni, mbrojtja e konsumatorëve dhe sportet amatore”.

³ Komisioni Evropian, 2011 COM(2011) 682 final “Krijimi i një klime të favorshme për ndërmarrjet sociale, aktorët kyç në ekonominë sociale dhe inovacion” Gjetet në Url: <https://www.fi-compass.eu/sites/default/files/publications/social-business-initiative-creating-a-favourable-climate-for-social-enterprises-key-stakeholders-in-the-social-economy-and-innovation.pdf>

Përmbledhje e Paketës Ligjore mbi Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri

Hapat e para për hartimin e një kuadri ligjor mbi sipërmarrjen sociale në Shqipëri kanë nisur që në 2010 me iniciativën e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (tashmë Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale). Në 2016, qeveria shqiptare miratoi Ligjin 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”.⁴ Nga 2010 deri në 2016 ka pasur përpjekje të vazhdueshme të sektorit për të bllokuar projekt-ligjin fillestar, i cili përmbante disa problematika. Nga ana tjetër, projekt-ligji nuk gjeti as dakortësinë e Ministrisë së Financave të asaj kohe për shkak të TVSH-së së reduktuar që propozonte për ndërmarrjet sociale. Edhe gjatë prezantimit të draft-ligjit të ri më 2016, një grup organizatash të shoqërisë civile dhanë një sërë rekomadimesh prej të cilave, e vetmja që u morr parasysh pjesërisht ishte kualifikimi për dhënien e statusit të ndërmarrjes sociale, jo vetëm “organizatave jofitimprurëse me anëtarësi”, por të gjitha organizatave jofitimprurëse. Kështu që ligji u aprovua në Kuvend qysh në krye të herës pa dakortësinë dhe me kundërshtimin e sipërmarrjeve sociale në vend.

Gjatë një periudhe prej 3 vitesh është plotësuar paketa ligjore përkatësisht me vendimet, udhëzimet dhe urdhërat e mëposhtëm:

- ✓ Vendimi Nr. 16/2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”;
- ✓ Vendimi Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 607/2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”;
- ✓ Vendimin Nr. 16/2017 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 677/2018 “Për përcaktimin e formave, afatave dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale”;
- ✓ Vendimi Nr. 789/2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”;
- ✓ Urdhëri Nr. 636/2018 “Për miratimin rregullores tip të funksionimit të ndërmarrjeve sociale”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 2/2019 “Për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve sociale dhe rregullat për mbajtjen e tij”.

⁴ Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjes Sociale në Republikën e Shqipërisë”, datë 9 qershor 2016. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf

Tre vite pas aprovimit të ligjit dhe plotësimit të paketës ligjore, ende asnjë organizatë jofitimprurëse nuk ka marrë statusin e ndërmarrjes sociale. Paketa pritet ende të plotësohet me udhëzimin mbi procedurat dhe dokumentacionin për heqjen e statusit të ndërmarrjes sociale (Ligji Nr. 65/2016, neni 14, pika 2).

Analiza e kuadrit ligjor

Përqasja e Ligjit

→ *Sipërmarrje sociale apo ndërmarrje sociale*

Qysh në fillimet e diskutimeve mbi nevojën e rregullimit ligjor të sipërmarrjes sociale në vend, ka pasur debat mbi terminologjinë “**sipërmarrje sociale**” përkundrejt “**ndërmarrje sociale**”. Në kuptimin e Ministrisë, “sipërmarrja sociale” duhet kuptuar si një entitet fitimprurës (kompani private) që kryen aktivitet me qëllim social, ndërsa “ndërmarrja sociale” si një aktivitet që kryhet nga organizatat jofitimprurëse që në thelb ka qëllimin social, dhe ofron shërbime sociale, si dhe punëson persona nga grupet e marginalizuara. Ligji në fuqi rregullon ndërmarrjet sociale, ndërkohë që pritet që qeveria të propozojë një ligj të veçantë për sipërmarrjen sociale. Ligji ndonëse prezanton dhe synon të rregullojë një veprimtari dhe entitet të ri, nuk jep një përcaktim të qartë se çfarë quhet ndërmarrje sociale. Mungesa e këtij përcaktimi sjell më pas paqartësi në kuptimin dhe trajtimin e ndërmarrjes sociale.

→ *Entitet i ri apo status për veprimtarinë*

Mungesa e një përkufizimi të ndërmarrjes sociale kontribuon dhe në paqartësinë nëse ligji flet për një entitet të ri ligjor apo status që akordohet bazuar në një seri kriteresh. Për shembull sipas nenit 14, pika 1 e ligjit, “*ndërmarrja sociale mund të humbasë statusin nëse ka ndërprerë veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj ose është shpërndarë*”, duke shkaktuar paqartësi nëse i referohet ndërmarrjes sociale apo organizatës jofitimprurëse.

Kjo paqartësi bëhet e dukshme dhe shqetësuese sidomos kur flitet për kriteret që një organizatë jofitimprurëse duhet të plotësojë për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale ku një nga kriteret ka të bëjë me nivelin e të ardhurave dhe përqindjen e tyre nga aktiviteti ekonomik. Përkatësisht neni 8, pika 2 e ligjit përcakton se të paktën **20%** e të ardhurave pas vitit të dytë dhe **30%** e të ardhurave pas vitit të tretë duhet të gjenerohen nga aktiviteti ekonomik. Ndërkohë, përveç përfshirjes së vullnetarëve, ndërmarrjet sociale duhet të punësojnë të paktën **3** punonjës të paguar me kohë të plotë (neni 8, pika 3). Përsa i përket *kriterit social*, ligji i detyron ndërmarrjet sociale që të paktën **30%** e punonjësve duhet të punësohen nga grupet e marginalizuara (neni 9, pika 2). Ligji shprehimisht vendos *kufizimin e mosshpërndarjes së fitimit* te anëtarët/pronarët, por investimin e fitimit tërësisht me qëllim zgjerimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e ndërmarrjes sociale (neni 17, pika 2). Ndërkohë, pavarësisht se ligji shprehimisht thotë që këto kritere duhen

plotësuar për të mbajtur statusin dhe jo për të marrë statusin, në Udhëzimin Nr. 607/2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale” (pika 2) përcaktohet që në kërkesën me shkrim që organizata bën për marrjen e statusit duhet të parashtrijë arsyet sesi i përmbush kriteret e mësipërme. Pra, ligji krijon konfuzion se cilat kriteret duhen plotësuar për të marrë statusin dhe cilat duhet të plotësohen për të mbajtur statusin.

→ *Sipërmarrje e pavaruar apo sipërmarrje me varësi shtetërore*

Ligji i koncepton ndërmarrjet sociale si entitete që financimin e veprimtarisë së tyre e mbështesin vetëm në fondet publike. Ky konceptim për rrjedhojë sjell përfshirje të drejtëpërdrejtë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucioneve të tjera publike si njësitë e qeverisjes vendore në vendimmarrjen e ndërmarrjes, duke shkuar deri në përcaktimin e pagave të punonjësve, gjë e cila çënon rëndë pavarësinë e tyre (neni 17, pika 4). Ligji (neni 17, pika 4) përcakton se pagat e punonjësve të ndërmarrjes sociale “*nuk duhet të kalojnë më shumë se 20% të pagave të punonjësve në sektorë të ngjashëm dhe punë të ngjashme*”, edhe pse në Shqipëri nuk ka një sistem referimi pagash për profesione të ndryshme të lira. I vetmi sektor që ka një strukturë pagash është administrata publike dhe institucionet e pavaruara që financohen me fonde nga buxheti i shtetit. Në këtë rast plotësimi i këtij detyrimi është i pamundur për t’u realizuar dhe monitoruar.

Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet në punë, rregullorja tip Nr. 636/2018 (neni 12) përcakton ndër të tjera edhe rregulla për mënyrën sesi duhen bërë paradhëniet për punonjësit, afatet e shlyerjes dhe detaje të tjera që konsiderohen si ndërhyrje e tepruar dhe e pajustificuar në operacionet e brendshme të ndërmarrjes sociale.

Sipas rregullores tip të funksionimit të ndërmarrjeve sociale Nr. 636/2018, ndërmarrja sociale duhet të nënshtrohet dhe **auditimit të jashtëm** çdo vit dhe në çdo rast, pa përcaktuar nëse ky detyrim lidhet me financimin apo jo të tyre nga fondet publike. Ndërkohë që ligjërisht ndërmarrja sociale është e regjistruar si organizatë jofitimprurëse, këto të fundit janë të përjashtuara nga kjo kërkesë. Auditimi i jashtëm është kusht për organizatat jofitimprurëse vetëm në rast e financimit nga fondet publike, ose për kompanitë private kur ato plotësojnë disa kriteret ligjore si totali i aktiveve, të ardhurave dhe numri i punonjësve. Kjo kërkesë lë të nënkuptohet se ligjëvënësi e ka marr si të mirëqenë që ndërmarrja sociale financohet vetëm me fonde publike.⁵

Përsa i përket **qeverisjes me pjesëmarrje** si një nga kriteret e sipërmarrjes sociale, në ligj (neni 16) përmendet që “*veprimtaria e ndërmarrjeve sociale drejtohet nga organet vendimmarrëse dhe organet ekzekutive, duke përfshirë në vendimmarrje edhe aktorë të tjerë, të tillë si punonjësit, vullnetarët, përdoruesit e shërbimeve dhe blerësit e mallrave, organet e*

⁵ Referojuni nenit 41 të Ligjit Nr. 10091/2009 “Për auditimin Ligjor, Organizimit e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”. Gjetet në Url: https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/09/Ligji_i_auditimit-konsoliduar.pdf

qeverisjes vendore dhe çdo aktor tjetër të interesuar. Përfshirja e pushtetit vendor në vendimmarrje e bën të vështirë interpretimin e kësaj pike nga ndërmarrjet sociale. Ky kriter gjendet dhe në nenin 5 (pika 2) e rregullores tip të funksionimit të ndërmarrjes sociale. Kjo pikë përforcon konstatimin e mësipërm ku sipas përjasjes së ligjit, ndërmarrjet sociale trajtohen si entitet publik duke dëmtuar parimin e autonomisë dhe demokracisë së brendshme.

Megjithatë, mënyra e përfshirjes të këtyre aktorëve është evazive, pasi as rregullorja tip nuk e shpjegon sesi ndërmarrja sociale duhet ta përfshijë secilin aktor në anëtarësi dhe vendimmarrje.

Kuti 1: Praktika Evropiane lidhur me qeverisjen me pjesëmarrje

- ✓ Sipas Ligjit Italian mbi kooperativat sociale, qeverisja bazohet në parimin “një anëtar, një votë”. Vullnetarët mund të përbëjnë **deri në 50%** të anëtarëve të sipërmarrjeve sociale me të drejtë vote. Gjithashtu, punonjësit duhet të jenë anëtarë të kooperativave (Traversi, 2019).
- ✓ Kuadri Ligjor në Portugali dhe Francë përcakton që **përdoruesit e shërbimeve dhe punonjësit** mund të jenë anëtarë të ndërmarrjeve sociale. Ndërkohë në vende të tjera nuk është e rregulluar me ligj, por aktorët mund të marrin pjesë përmes **kanaleve jo-formale**, si pjesëmarrja e përdoruesve dhe punonjësve në komisione/aktivitete të ndryshme gjatë veprimtarisë së ndërmarrjes (Defourny & Nyssens, 2012).

→ Zhvillim nëpërmjet mbështetjes apo penalizimit

Kuadri ligjor është i ngarkuar me një seri sanksionesh që variojnë që nga kufizime deri në gjoba për përdorimin e emrit “ndërmarrje sociale“, apo mospërbushje kriteresh, çka i jep këtij ligji **një qasje më shumë penalizuese sesa mundësuese** duke krijuar disproporcionalitet midis përfitimeve të munguara dhe penalteteve të shumta.

Ligji nuk parashikon të drejtën e ankimimit, si një e drejtë kushtetuese, gjë e cila është shumë e rëndësishme sidomos në rastin e mos njohjes së statusit të ndërmarrjes sociale.

E drejta vendimmarrëse për regjistrimin, çertifikimin, vlerësimin e aplikimeve për përfitim të subvencioneve, kontrollin si dhe heqjen e statusit i është dhënë në mënyrë ekskluzive *Ministrit për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale*. Kjo e bën procesin tepër të centralizuar, më shumë politik sesa teknik.

Modeli i ndërmarrjes sociale sipas ligjit

Qasja e ligjit shqiptar është e fokusuar krejtësisht te **modeli për integrimin në punë të grupeve të marginalizuara** (WISE). Sipas ligjit, statusi mund të merret vetëm nga organizatat jofitimprurëse që ofrojnë të mira dhe shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit në sektorin e shërbimeve shoqërore, shëndetësore, kulturore e arsimore, të promovimit të turizmit e

mbrojtjes mjedisore, ndërmjetësimit e kualifikimit për punësim, punësimin rinor. Kjo qasje është testuar dhe në vende të tjera të Ballkanit dhe Evropës, por nuk ka rezultuar e suksesshme nëse ndërmarrjet sociale shihen vetëm si mekanizëm për përfshirjen e grupeve të marginalizuara.⁶

Ligji njih si ndërmarrje sociale ato organizata jofitimprurëse që punojnë *për integrimin në punë të grupeve të marginalizuara* (WISE), të cilat gjithashtu ofrojnë dhe *shërbime në fushën sociale dhe edukative* kryesisht për këto grupe (neni 2, pika c dhe neni 11 pika 1). Në këtë kuptim ligji gërsheton brenda të njëjtit entitet dy qëllime veprimtarie, ndërkohë që ato në vetvete janë të ndryshme jo vetëm për nga fokusi, por edhe ekspertiza që kërkojnë, sfidat e ndryshme në zbatim, përfshirë këtu edhe mundësitë e (vetë) financimit. Edhe praktika evropiane i trajton këto qëllime veprimtarie në mënyrë të ndarë. Duket sikur qëllimi i vetëm i ligjit me këtë është të adresojë punësimin dhe integrimin e grupeve të marginalizuara, një strategji që në të ardhmen do të lehtësojë barrën e shtetit duke ulur numrin e personave që marrin ndihmë sociale.

Në përgjithësi vendet në Bashkimin Evropian bëjnë një kategorizim të a) *ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime në fushën sociale*, të edukimit, kulturës etj, si dhe b) *ndërmarrjeve që ofrojnë produkte dhe shërbime të natyrave të ndryshme, nëpërmjet punësimit të personave nga grupe të marginalizuara*.

Kuti 2: *Dy tipologjitë e Sipërmarrjes Sociale në vende të Evropës*

- Ligji Italian Nr.381 i ndan sipërmarrjet sociale në dy tipologji:
 - a) Kooperativa sociale **Tipi A**, të cilat ofrojnë *shërbime në fushën sociale*, të shëndetit dhe atij edukativ;
 - b) Kooperativa sociale **Tipi B**, të cilat kryejnë *aktivitetet të çfarëdolloji ekonomik* duke punësuar persona nga grupe të marginalizuara.
- I njëjti model është ndjekur dhe nga **Slovenia, Portugalia, dhe Spanja** (Fici, 2015).

Forma e Organizimit

Ligji përcakton që e vetmja formë ligjore që mund të marrë statusin e ndërmarrjes sociale janë **organizatat jofitimprurëse** (Ligji Nr. 56/2016, neni 20). Ligji në këtë mënyrë përjashton të gjitha format e tjera të entiteteve ligjore siç janë kompanitë private (person fizik dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe kooperativat, të cilat operojnë bazuar në parimet e sipërmarrjes sociale dhe që kualifikohen si të ligjshme nga pjesa dërmuese e legjislacionit në vendet e BE-së. Rrjedhimisht, kjo bën që të përjashtohen disa forma që sjellin një vlerë të shtuar në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe të cilat nxisin inovacionin social dhe teknologjik.

⁶ EMES Network & Euricse, 2019 “Social Enterprises and their Ecosystems: Recent Development in Europe” – Seminar Paper

Kuti 3: Praktika Evropiane përsa i përket njohjes së formave ligjore diverse

- Kuadri Ligjor në shumë vende si: **Greqia, Italia, Kroacia, Britania e Madhe dhe Franca** etj. njih forma të ndryshme ligjore të organizimit që kualifikohen si ndërmarrje sociale.
- Vende si Britania e Madhe dhe Franca kanë krijuar dhe një formë specifike përveç formave të tjera, përkatësisht: **Kompanitë me Interes Komunitar, Kooperativa Sociale me Interes Kolektiv.**

Kriteret Ekonomike dhe Sociale në ligj

Përsa i përket kriterëve ekonomike, sociale dhe riinvestimit të fitimit, ligji e kufizon ndërmarrjen sociale në të gjithë këto parametra.

Lidhur me *kriterin ekonomik*, në ligj vendosen kushte mbi numrin minimal të punonjësve me kohë të plotë (të paktën **3**) si dhe një përqindje të detyrueshme e të ardhurave që duhet të vijnë nga aktiviteti ekonomik, respektivisht të paktën **20%** për vitin e dytë dhe **30%** për vitin e tretë (neni 8, pika 2 dhe 3). Mbetet e paqartë nëse këto lloj përqindjesh janë bazuar në ndonjë studim, i cili tregon trendin e rritjes së sipërmarrjeve sociale dhe kapacitetin e tyre për tu zgjeruar. Po kështu, punësimi i **3** punonjësve me kohë të plotë që në fillim konsiderohet **shtrëngues** nga organizatat që duan të regjistrohen si ndërmarrje sociale.

Kuti 4: Praktika Evropiane mbi kriteret ekonomike

- Shumica e vendeve Evropiane **nuk kanë kufizime** mbi numrin e punonjësve, përveç Sllovenisë, e cila vendos minimumi **1** vitin e parë vetëm për **Tipin A** të sipërmarrjes sociale që ofron shërbime sociale, dhe jo për Tipin B që punëson grupe të marginalizuar.
- **Kroacia dhe Britania e Madhe** kanë një kufizim **prej 25 %** të aktivitetit që duhet të vijë nga ai ekonomik (Në Kroaci, ky kufizim është për sipërmarrje sociale që kanë të paktën 3 vjet të regjistruara). Vende si Sllovenia vendosin një kufizim vetëm për **Tipin A** të sipërmarrjes.
- **Greqia** vendos kufizim jo më shumë se **65%** e të ardhurave duhet të vijë nga subjektet publike.

Gjithashtu lidhur me *kriterin social* vendoset kushti që **30%** e punonjësve duhet të vijnë nga grupet e marginalizuara (neni 9, pika 2). Vendimi Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara” paraqet një listë prej 28 kategori grupesh të marginalizuara të synuara për t’u punësuar nga ndërmarrjet sociale. Por, vendimi nuk jep asnjë qartësi mbi kriteret sesi vlerësohen këto grupe, të domosdoshme më pas për ndërmarrjen sociale që të provojë plotësimin e tyre.

Po kështu në formatet e raportimit që ndërmarrja sociale duhet të bëjë çdo vit sipas udhëzimit Nr. 677/2018 “Për përcaktimin e formave, afatave dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale” nuk kërkohen dokumenta mbështetës për **vërtetimin** e këtyre grupeve të marginalizuara.

Disa nga grupet që mbivendosen apo janë të vështira për tu vërtetuar në vendimin Nr. 56/2018 janë: pika e) punonjësit migrantë që zhvendosen ose janë zhvendosur brenda vendit; g) persona që i përkasin moshës mbi 50 vjeç, i) personat, të cilët nuk kanë pasur punën e tyre të parë të paguar rregullisht që nga fillimi i vuajtjes së dënimit me heqje lirie, me dënim alternativ apo çdo lloj dënimi tjetër penal; i) gratë që jetojnë në zona rurale: ku niveli mesatar i papunësisë e kalon 50% të nivelit mesatar kombëtar për të paktën dy vjet kalendarikë; ii) gratë që jetojnë në zona rurale: ku papunësia e gjinisë femërore është mbi 150% të nivelit mesatar të papunësisë së gjinisë mashkullore për të paktën dy nga tre vjetët e fundit kalendarikë etj.

Kuti 5: Praktika Evropiane mbi kriterin social

- Vende si **Greqia, Italia dhe Sllovenia** vendosin një kufizim prej **30-40%** e të punësuarve nga grupet e marginalizuara, por vetëm për njërën nga llojet e ndërmarrjeve (modelin e integritimit në punë të grupeve të marginalizuara).
- Vendet e tjera si psh. **Britania e Madhe, Franca, Kroacia** nuk vendosin një kufizim të tillë.

Financimi i ndërmarrjeve sociale

→ *Manaxhimi i burimeve të veta*

Sipas ligjit, pavarësisht se ndërmarrja sociale është e detyruar që ta përdori “*fitimin tërësisht për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj*” (neni 17, pika 2), “*ato duhet të taton për fitimin e realizuar, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat*”⁷ (neni 17, pika 1). Në këtë rast, ka një kundëbalancë midis përjashtimit tatimor të munguar dhe kufizimit për mos shpërndarjen e fitimit. Ligji nuk jep asnjë hapësirë për ndërmarrjen sociale që ta përdori fitimin në forma të ndryshme investimi, apo shpërblime dhe rritje pagash për punonjësit (neni 17, pika 3 dhe 4). Kjo qasje kufizuese vendos në pikëpyetje vazhdimësinë dhe qendrueshmërinë e këtyre ndërmarrjeve, i paragjykon ato lidhur me kapacitetet njerëzore që (duhet të) përdorin, dhe nuk mundëson rekrutimin dhe mbajtjen e talenteve dhe ekspertizës.

⁷ Ligji Nr. 8438/2018 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” ndryshuar, datë 28 Dhjetor 1998. Link: <http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/taksa%20sistemi/ligj%20nr%20%208438%20dt%20-28%2012%201998%20i%20perditesuar.%202017.%201.pdf>

Në vendet e Bashkimit Evropian, sipërmarrjet sociale lejohen që një pjesë të fitimit ta shpërndajnë për zgjerimin e veprimtarisë në formë investimi, bonusi për punonjësit, fond rezervë etj dhe një përqindje e caktuar mund të mbahet nga sipërmarrësi social, apo anëtarët.

Si rrjedhojë, gjithë fitimi që riinvestohet dhe nuk mbahet nga sipërmarrësi nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin.

Kuti 6: Praktika Evropiane mbi shpërndarjen e fitimit

- Për shembull, **Kroacia** përcakton që të paktën **75%** duhet të shkojë për zgjerimin e aktivitetit dhe qëllimit social.
- **Greqia** përcakton që **60%** e fitimit duhet të shkojë për zgjerimin e aktivitetit; **35%** bonus për punonjësit; **5%** fond rezervë.
- **Italia** përcakton që deri në **50%** e fitimeve mund të shpërndahen në tre forma: a) rritje të kapitalit; b) kontribut për organizatat e sektorit të tretë; c) *shpërndarje fitimesh te aksionerët* (Salatino, 2018).

Kuti 7: Praktika Evropiane mbi incentivat fiskale për sipërmarrjet sociale

- Në **Itali** me ndryshimet e fundit ligjore, sipërmarrjet sociale marrin *përjashtim mbi fitimet e riinvestuara*. Në **Greqi**, sipërmarrjet sociale marrin *përjashtim tatimor për përfitimet e marra nga punonjësit*.
- Disa nga vendet si **Britani e Madhe** dhe **Franca** kanë dhe kriterin e ashtuquajtur “**asset lock**” që konsiston në mos shpërndarjen e asetëve të anëtarët e kompanisë, aksionerët apo punonjësit.
- Për të nxitur investimin në sipërmarrjet sociale, **Italia** për shembull ka vendosur një *nxitës që sipërmarrësit që investojnë në ndërmarrje sociale*, të cilat nuk kanë më shumë se **36 muaj** në treg mund të përfitojnë zbritje në tatimin mbi të ardhurat deri në **30%** të kapitalit të investuar në ndërmarrjen sociale (Salatino, 2018).

Bazuar në këtë analizë, pikëpyetja që lind është se çfarë vlere të shtuar dhe lehtësirash sjell ky ligj për organizatat jofitimprurëse që operojnë tashmë si sipërmarrje sociale, kur aktualisht organizatat jofitimprurëse kanë disa përfitime si rrjedhojë e Ligjit Nr. 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”⁸ dhe dy amendamentet e fundit shtesë në 2007⁹ dhe në 2013.¹⁰

⁸ Ligji Nr. 8788 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, datë 7.5.2001. Linku: http://www.akdie.org/sites/default/files/ligj_per_ojf.pdf

⁹ Ligji Nr. 9814 “Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, 4 Tetor 2007. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/138-2007.pdf

¹⁰ Ligji Nr. 92 “Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, 28 Shkurt 2013. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/36-2013.pdf

Organizatat jofitimprurëse mund të kryejnë aktivitet ekonomik deri në **20%** të totalit të të ardhurave me kushtin e vetëm që aktiviteti ekonomik të lidhet me misionin dhe të përdoret për avancimin e tij pa u tatuar mbi fitimin. Gjithashtu, organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime në fushat sociale, edukuese, kulturore dhe sportive janë të përjashtuara nga TVSH-ja për 3 vjet.

→ *Financimi Publik*

Përsa i përket formave të mbështetjes nga shteti, Vendimi Nr. 789/ 2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale” parashikon krijimin e fondit prej 249,760,000 lekë për periudhën 2019-2021. Fondi subvencionon:

a) *veprimtarinë* e ndërmarrjeve sociale – Fondi mbulon deri në 70% të kostove të pranuar, por jo më shumë se 1,500,000 lekë. Kostot e pranuar përfshijnë: a) investim në makineri/pajisje; b) për kualifikimin dhe trajnimin për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara; c) mbulimin deri në 50% të pagës minimale për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, për një periudhë gjashtë mujore;

b) *vendet e reja të punës* për personat nga grupet e marginalizuara – Fondi është në dispozicion për ndërmarrje sociale që reflektojnë rritje të numrit të të punësuarve me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara. Për çdo vend të ri pune, ndërmarrjet mund të përfitojnë deri në 100,000 lekë që mund të përdoren për mjete pune, lëndë të parë dhe materiale konsumi me kusht që kohëzgjatja e punës të jetë jo më e vogël se 2 vjet;

c) *sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shoqërore* për këtë kategori punonjësish – Ndërmarrja sociale mund të përfitojë një financim vjetor deri në masën 100% të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të jetë jo më e vogël se 2 vjet.

Ka disa pika në këtë vendim që konsiderohen **evazive** ose **kufizuese**:

→ Pika 7 e vendimit përcakton që ndërmarrjet sociale duhet të paraqesin një *projekt-propozim*, ose *plan biznesi* për të përfituar nga fondi duke mos përcaktuar një format aplikimi si dhe kriteret mbi të cilat do të vlerësohen aplikimet;

→ Bazuar në pikën 10 (c) të vendimit, për të përfituar subvencionin për zhvillimin e veprimtarisë kërkohet që ndërmarrja sociale të punësojë **minimalisht 3** (tre) *punonjës të rinj* nga kategoritë e grupeve të marginalizuara brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit. Që një ndërmarrje sociale të marrë statusin duhet të ketë 3 punonjës me kohë të plotë (ku ndër ta **30%** janë nga grupet e marginalizuara), ndërkohë bazuar në këtë vendim me qëllim që të përfitojë nga fondi ndërmarrja duhet të punësojë dhe 3 të tjerë nga këto grupe (pra duhet të ketë të paktën 6 punonjës në total). Edhe në rastin e subvencionit për vende të reja pune kërkohet që ndërmarrja sociale të rrisë

numrin e punonjësve që të marrë këtë lloj subvencioni (pika 12). Kjo përbën një kufizim të madh për ndërmarrjet sociale duke marrë parasysh kapacitetin e tyre të mjaftueshëm në burime njerëzore.

- Pika 16 dhe 17 e vendimit përcakton se subvencioni i marrë nuk përjashton dhe format e tjera të financimit nga buxheti shtetëror me kufizimin që financimet në total nga buxheti i shtetit (përfshirë të gjitha format) **nuk duhet të kalojnë shumën 14,000,000 lekë** për një periudhë prej 3 vjetësh. Në këtë rast mbetet e paqartë sesi provohet apo kontrollohet një kusht i tillë.
- Për të aplikuar për fondin, si dokumentacion kërkohet vendimi i gjykatës për regjistrimin si organizatë jofitimprurëse dhe NIPT, dokumente të panevojshme pasi subjekti që do aplikojë duhet të ketë marrë statusin e ndërmarrjes sociale (pika 18). Ky status merret vetëm në qoftë se plotëson kushtin e regjistrimit si organizatë jofitimprurëse. Edhe në këtë rast shihet se marrja e subvencionit ngarkohet me dokumenta të panevojshëm.

→ *Prokurimi Publik*

Përveç fondit të vendosur në dispozicion që përcakton llojet e subvencionimit për ndërmarrjet sociale, paketa ligjore **nuk merr parasysh format e mbështetjes nga pushteti vendor dhe prokurimin publik**. Ligji nuk i përjashton ndërmarrjet sociale nga prokurimi publik, por nga eksperiencia organizatat jofitimprurëse e kanë pasur të vështirë të përfitojnë fonde nga prokurimi publik bazuar në kriteret e vendosura në ligj.¹¹ Pavarësisht se në nenin 27 të ligjit përmendet që ndërmarrjet sociale mund të marrin pjesë në prokurimin publik, përsëri çështja mbetet e pazgjidhur. Prezantimi i **prokurimit social** si një formë që ka në bazë jo thjesht çmimin konkurrues, por impaktin social është i rëndësishëm për ti dhënë mundësi dhe avantazh ndërmarrjeve sociale (Partnerët Shqipëri, 2014). Ky është dhe një rekomandimet që Komisioni Evropian ka nxjerrë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sociale (Komisioni Evropian, 2016). Pjesa më e madhe e sipërmarrjeve sociale në vendet e BE-së janë zhvendosur nga përfitimi i granteve në prokurimin publik gjatë dy dekadave të fundit, si një mjet financimi shumë i rëndësishëm për mbijetesën dhe zhvillimin e këtyre entiteteve (Komisioni Evropian, 2016).

¹¹ Ligji Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, datë 20 Nëntor 2006, me amendimet e fundit në 2018. Linku: <http://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=0e11826f-ddab-45e9-9e7d-2d8793c55b94>

Kuti 8: Praktika Evropiane mbi prokurimin publik nga sipërmarrjet sociale

- ✓ Në Itali, **70%** e të ardhurave të kooperativave sociale te tipit A dhe të atyre mikse vijnë nga prokurimi publik, ndërsa në kooperativat sociale të tipit B (**57.1%**) e të ardhurave vjen nga kontratat/marrëveshjet me institucionet shtetërore (Borzaga, Poledrini, & Galera, 2017). Italia ka integruar rregullat e BEsë për përfshirjen e kritereve sociale në prokurimin publik.
- ✓ Sllovakia ka përfshirë disa kritere *sociale, mjedisore dhe etike* si shumë thelbësore për të përfituar fonde nga prokurimi publik (Komisioni Evropian, 2016).

Nga ana tjetër, vihet re që ka një **mangësi integrimi apo koordinimi** midis strategjisë kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe Ligjit Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Sipas Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 janë marrë një sërë masash për të ndërtuar një rrjet të qëndrueshëm shërbimesh sociale të decentralizuara në përputhje dhe me reformën administrative-territoriale.¹² Janë decentralizuar shërbimet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidenciale për grupet në nevojë (fëmijë, PAK të moshuar, viktimat trafikimi). Në strategji është parashikuar që këto shërbime të kontrahohen nga organizatat jofitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve, çka parashikon zvogëlimin e kostove të investimit fillestar dhe lejon fleksibilitet në ofrimin e shërbimit. Mundësia e prokurimit të shërbimeve sociale do të mundësojë ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave të bashkive. Shërbimi Social Shtetëror është përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen teknike në njësitë vendore, ndërkohë që inspektoriat do të mbikqyrë shërbimet. Bashkia vlerëson, planifikon nevojat si dhe merret me shpërndarjen e shërbimeve. Në strategji theksohet se ende mbetet sfida analiza dhe gjetja e modelit më të përshtatshëm të decentralizimit të shërbimeve, e harmonizuar kjo me reformën territoriale që po zbatohet në vend (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 2015).

Strategjia e re Kombëtare për Mbrojtjen Sociale duhet të bëjë parashikojë bashkëpunimin e pushtetit vendor me ndërmarrjet sociale për kontraktimin e shërbimeve sociale si dhe duhet të krijohen hapësirat e duhura për konkretizimin e këtij bashkëpunimi në praktikë.

¹² Ligji Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-territoriale të Njësitë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, datë 31.7.2014. Linku: http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/Ligji_115_2014.pdf

Përfundime

Bazuar në analizën e mësipërme ka një sërë konkluzionesh të rëndësishme që duhen të dalin në pah dhe të rishikohen nga ligjvënësit për të krijuar një mjedis ligjor mundësues.

- ✓ **Mungesa e një përkufizimi të konceptit “sipërmarrje sociale” dhe “ndërmarrje sociale”** e ka orientuar ndërmarrjen sociale sipas ligjit drejt modelit për integrimin në punë të grupeve të marginalizuara (modeli WISE). Sipas kuadrit ligjor duket se bëhet një mbivendosje pasi ndërmarrjet sociale duhet të bëjnë integrimin në punë të grupeve të marginalizuara si dhe të ofrojnë shërbime sociale. Praktika Evropiane i trajton këto modele të ndara zakonisht në dy tipologji ndërmarrjesh sociale. Ndërkohë, raportet e Komisionit Evropian mbi sipërmarrjen sociale në Evropë tregojnë që në vende ku ndërhyrjet legislative kanë legjitimuar vetëm forma të caktuara të ndërmarrjeve sociale (si modeli i integritimit në punë të grupeve të marginalizuara - WISE), kanë kontribuar në errësimin dhe reduktimin e ekosistemit të gjerë de-facto të sipërmarrjeve sociale.⁶
- ✓ **Dhënia e statusit të “ndërmarrjes sociale” vetëm organizatave jofitimprurëse** duke lënë jashtë të gjitha format e tjera ekzistuese (kompani, kooperativa, shoqata kursim krediti) që përmbushin parimet e sipërmarrjes sociale është një nga problematikat kryesore të ligjit. Bazuar në praktikën evropiane, impakti i hartimit të një ligji dedikuar sipërmarrjes sociale ka qenë i frytshëm vetëm kur janë njohur të gjitha tipologjitë ekzistuese të sipërmarrjeve sociale pa vendosur kufizime strikte dhe kur sektori i sipërmarrjes sociale është përfshirë në procesin e hartimit të legjislacionit.⁶
- ✓ **Vendosja e një sërë kriteresh ekonomike dhe sociale të shoqëruara me një sërë penalitetesh dhe paqartësish** se cilat kritere aplikohen për marrjen e statusit dhe cilat për mbajtjen e tij e bën akoma më të vështirë barrën për ndërmarrjet sociale duke marrë parasysh kapacitetet e tyre. Bazuar në praktikën evropiane të lartpërmendura, kriteret e vendosura janë më të buta dhe zakonisht vendosen për një nga llojet e sipërmarrjeve sociale, të cilat kanë nga ana tjetër disa incentiva nga ana e shtetit.
- ✓ **Trajtimi i ndërmarrjes sociale si një entitet i varur nga fondet shtetërore**, pavarësisht se është në zgjedhjen e këtyre entiteteve nëse dëshirojnë të aplikojnë për fondin në dispozicion është një qasje që mbizotëron në të gjithë paketën ligjore që nga trajtimi i punonjësve deri te përfshirja e pushtetit vendor në qeverisje. Është i pajustificueshëm niveli i lartë i ndërhyrjes së shtetit në këto entitete, një trajtim i cili nuk gjendet në asnjë nga praktikën e mira të vendeve evropiane.
- ✓ **Mungesa e marrjes parasysh të formave të mbështetjes nga pushteti vendor dhe përfshirjes së prokurimit social në prokurimin publik** përbën një nga boshllëqet e tjera të kuadrit ligjor. Praktika Evropiane tregon që pjesa më e madhe e të ardhurave për ndërmarrjet sociale që bëjnë integrim të grupeve të marginalizuara, por dhe atyre që ofrojnë shërbime sociale vjen nga prokurimi publik apo kontrata direkte me pushtetin vendor. Rregullimi i këtyre dy instrumentave është shumë i rëndësishëm për ti dhënë një

shtytje ndërmarrjeve sociale për të operuar në treg duke pasur parasysh disavantazhet që kanë krahasimisht me sipërmarrjet tradicionale.

- ✓ **Përdorimi i fitimit tërësisht për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së tyre**, pa përcaktuar aspak format sesi mund të përdoret ky fitim dhe për më tepër **duke i tatuuar për fitimin e realizuar** (pavarësisht se fitimi riinvestohet tërësisht) është po ashtu një kufizim shumë i madh për sipërmarrësit socialë. Praktika Evropiane i përjashton sipërmarrjet sociale nga tatimi mbi fitimin për fitimet e riinvestuara qoftë në ndërmarrje apo si shpërblime për punonjësit. Nga ana tjetër, kuadri ligjor në vendet e Evropës i jep mundësinë sipërmarrësve social që të mbajnë një përqindje të caktuar të fitimit, apo aplikohen dhe incentiva të tjera të përmendura më sipër me qëllim nxitjen e investimeve në sipërmarrjet e reja sociale.

Parimisht një kuadër ligjor krijohet për të rregulluar praktikën e sipërmarrjes sociale, me qëllim inkurajimin e sipërmarrjes dhe inovacionit, e cila do të sjellë rrjedhimisht zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit. Por, kuadri aktual ligjor ka krijuar një valë skepticizmi në sektor dhe midis ekspertëve të fushës pasi mund të shkaktojë një dekurajim të shpirtit sipërmarrës dhe mund të sjellë madje deformime të modeleve të sipërmarrjes sociale në të ardhmen. Prandaj është e nevojshme që të ndërmerren masa për rishikimin e këtij kuadri ligjor me qëllim krijimin e një mjedisi mundësues dhe të favorshëm për të gjithë sipërmarrjet sociale ekzistuese dhe ato që do të krijohen në të ardhmen.

Referenca

- Austin, J., Stevenson, H., & Wei-Skillern, J. (2006). Social and commercial entrepreneurship: Same, different, or both? *Entrepreneurship Theory and Practice*, 30(1), 1-22.
- Borzaga, C., Poledrini, S., & Galera, G. (2017). Social Enterprise in Italy: Typology, Diffusion and Characteristics. *Euricse Working Papers*, 96(17).
- Defourny, J., & Nyssens, M. (2012). *The EMES approach of social enterprise in a comparative perspective*. Brussels, Belgium: EMES European Research Network.
- Fici, A. (2015). Recognition and Legal Forms of Social Enterprise in Europe: A Critical Analysis from a Comparative Law Perspective. *Euricse Working Papers*, 82(15).
- Komisioni Evropian. (2016). *Social enterprises and the social economy going forward*.
- Komisioni Evropian. (2016). *Social Enterprises and their Eco-systems: Developments in Europe*.
- Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2015). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020*.
- Partnerët Shqipëri. (2014). *Dokument Politikash Prokurimi Social në Shqipëri*.
- Petrella, F., & Richez-Battesti, N. (2014). Social entrepreneur, social entrepreneurship and social enterprise: semantics and controversies. *Journal of Innovation Economics & Management*, 14, 143-156.
- Salatino, G. (2018). *A spotlight on Italy: "The New Regulation of the "Social Enterprise"*. Gjetur në The Philanthropist: <https://thephilanthropist.ca/2018/08/a-spotlight-on-italy-the-new-regulation-of-the-social-enterprise/>
- Townsend, M., & Hart, A. (2008). Perceived institutional ambiguity and the choice of organizational form in social entrepreneurial ventures. *Entrepreneurship Theory and Practice*, 32, 685-700.
- Traversi, M. (2019). *The Italian Eco-system for social enterprises*.
- Yunus, M. (2010, June 15). *Social Business*. Gjetur në <https://www.forbes.com/2010/06/15/forbes-india-muhammad-yunus-social-business-opinions-ideas-10-yunus.html#147f49896522>

Partnerët Shqipëri dhe Sipërmarrja Sociale

Partnerët Shqipëri punon për zhvillimin e konceptit të sipërmarrjes sociale dhe ndërmarrjeve sociale (NS) përmes **kërkimit shkencor** për të kuptuar më mirë karakteristikat dhe modelet e NS-ve, sfidat që hasin me qëllim **edukimin** e aktorëve përkatës për të mbështetur rolin e NS-ve, si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Këto instrumente janë në funksion të përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues financiar dhe institucional për NSTë. Partnerët Shqipëri ka krijuar **një model mekanizmesh mbështetës** për start-upet duke ofruar financim, know-how dhe mundësi rrjetëzimi.

Kërkimi shkencor ka mbuluar çështje të identifikimit të sektorit, kuptimit të sfidave dhe mundësive në tregje lokale, mundësitë e financimit dhe mbështetjes institucionale, potencialit për rritje dhe rolin e shtetit e aktorëve jo publik në zhvillimin e sipërmarrjes sociale. Partnerët Shqipëri janë pjesë e shumë nismave të kërkimit shkencor mbi ndërmarrjet sociale dhe sipërmarrjen sociale në Ballkanin Perëndimor. Gjetjet e kërkimeve shkencore përbëjnë bazën e advokacisë në nivel kombëtar dhe Europian e mbështetur kjo dhe nga pjesëmarrja në rrjete të ndryshme si EMES, EUCLID, Balkan Social Enterprise Research Network, etj.

Partnerët Shqipëri ofron mbështetje në ndërtim kapacitetesh, mentorim, financim dhe ndërlidhje të bizneseve me sipërmarrje sociale si pjesë e disa programeve me mbështetje e donatorëve si Bashkimi Evropian, Ambasada Amerikane, Rockefeller Brothers Fund, Balkan Trust for Democracy, Telekom, Credins Bank etj.

Ky publikim vjen pas konferencës ndërkombëtare “Ndërmarrjet Sociale - Drejt Politikave dhe Praktikave Përfshirëse”, ku shumë aktorë të rëndësishëm si sipërmarrje sociale, organizata mbështetëse, donatorë, përfaqësues nga pushteti vendor dhe qendror u bënë bashkë dhe diskutuan ndër të tjerash dhe çështje që shqetësojnë sektorin lidhur me kuadrin ligjor. Nga inputet e dhëna gjatë konsultimeve të realizuara dhe diskutimeve të bëra gjatë konferencës janë evidentuar një sërë problematikash të lidhura me kuadrin ligjor që rezultojnë penguese për sipërmarrjet sociale, të cilat u finalizuan me një [deklaratë](#) përmbledhëse të dërguar pranë institucioneve publike përkatëse dhe atyre donatore nga organizata që punojnë në sektorin e sipërmarrjes sociale duke kërkuar ngritjen e një grupi për rishikimin dhe plotësimin e këtij kuadri ligjor.